



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 3

Tiranë – E martë, 17 janar 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 11.1.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”.....	21
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 11.1.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 648, datë 28.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për avokatin e tatimpaguesit”.....	38
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 11.1.2017	Për përcaktimin e rregullave të legalizimit të objekteve me leje ndërtimi, në të cilat janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshime të funksionit të hapësirave dhe të objekteve shumëkatëshe pa leje, të destinuara për kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien.....	40
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 41, datë 5.1.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 4, datë 27.5.2014, “Mbi kërkesat teknike dhe standardet e operimit të oficinës së autorizuar të tahografit”.....	43
Urdhër i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 6445/3, datë 9.1.2017	Për miratimin e tarifave zyrtare që do të zbatohen nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, për shërbimet e ofruara prej saj.....	44
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 5435/8, datë 5.1.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim-ndriçim i aksit rrugor blloku 11.2 ha në lagjen “Besëlidhja””, faza e tretë, Bashkia e Lezhës.....	44



VENDIM
Nr. 9, datë 11.1.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 921, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PERSONELIN E ADMINISTRATËS
DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 3, 8, 11, pika 4, dhe 15, pikat 11 e 12, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pjesët II deri X ndryshon sistemi i numeracionit, si më poshtë vijon:

a) Në pjesën II, pikat 7, 8, 9, 10 e 11 ndryshojnë, përkatësisht, në 1, 2, 3, 4, 5;

b) Në pjesën III, pikat 12, 13, 14 e 15 ndryshojnë, përkatësisht, në 1, 2, 3, 4;

c) Në pjesën IV, pika 16 bëhet 1;

ç) Në pjesën V, pikat 17, 18 ndryshojnë, përkatësisht, në 1, 2;

d) Në pjesën VI, pikat 19, 20, 21, 22, 23, 24, ndryshojnë, përkatësisht, në 1, 2, 3, 4, 5, 6;

dh) Në pjesën VII, pikat 25, 26, 27, 28, 29, ndryshojnë, përkatësisht, në 1, 2, 3, 4, 5;

e) Në pjesën VIII, pikat 30 e 31, ndryshojnë, përkatësisht, në 1, 2;

ë) Në pjesën IX, pika 32, bëhet 1.

2. Në pikën 13, të pjesës III, fjalët “...në pikën 10...” bëhen “...në pikën 4, të pjesës II...”.

3. Në pikën 20, të pjesës VI, hiqen fjalët “...dhe për punonjësit administrativë...”.

4. Pas pikës 20, të pjesës VI, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Procedura disiplinore për punonjësit administrativë kryhet në përputhje me Kodin e Punës.”.

5. Në pikat 21, 22, 23, të pjesës VI, hiqen fjalët “...apo punonjësi administrative...”.

6. Në fund të pikës 29, të pjesës VII, shtohet paragrafi, si më poshtë vijon:

“Në përputhje me shkronjën “h”, të paragrafit të parë të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe me pikën 4, të nenit 7, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, punonjësit e Drejtorisë së Hetimit, Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Drejtorisë Antitrafik, që kanë atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, trajtohen në përputhje me Kodin e Punës, legjislacionin doganor dhe me legjislacionin specifik, për këtë qëllim. Procedura e pranimit në administratën doganore të këtyre punonjësve kryhet në përputhje me pikën 6, të pjesës I. Procedurat e tjera zbatohen *mutatis mutandis*, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

7. Pika 31, e pjesës VIII ndryshon, me këtë përmbajtje:

“2. Punonjësit, që emërohet apo transferohet larg vendbanimit a vendqëndrimit të tij të zakonshëm, i sigurohet banesë ose një pagesë si kompensim për strehimin, si më poshtë vijon:

a) Kur nëpunësi doganor emërohet /transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda vendit, i paguhet qiraja e banesës, kur nuk i sigurohet ajo;

b) Nëpunësi doganor që emërohet/ transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda vendit, përfiton kompensim për qira banese, nëse emërohet/transferohet për shkak të detyrës dhe/ose për nevoja pune, në largësi mbi 45 km.;

c) Masa e kompensimit për qira banese, e përcaktuar në pikën 2, është, si më poshtë vijon:

i) Kur nëpunësi doganor nuk merr me vete, në vendemërimin e ri të punës, pjesëtarët e familjes, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 43.93 m²;

ii) Kur nëpunësi doganor ka në ngarkim edhe një person, dhe e merr në vendemërimin e ri të punës, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 56.47 m²;

iii) Kur nëpunësi doganor ka në ngarkim edhe dy persona, dhe i merr në vendemërimin e ri të punës, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 79.74 m²;

iv) Kur nëpunësi doganor ka në ngarkim edhe tre persona a më shumë, dhe i merr në vendemërimin e ri të punës, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 80.50 m².

ç) Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në



ngarkim të nëpunësit doganor vërtetohet me certifikatën e gjendjes familjare;

d) Njësia shpenzuese në DPD bën kompensimin e qirasë së banesës të nëpunësit doganor, përkundrejt paraqitjes së kontratës së qirasë, në vlerë jo më të madhe se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në vendimin nr. 469, date 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”. Vlera minimale mujore e çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira do të përlogaritet në bazë të vlerës mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë, sipas njësive administrative, të përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”, që miratohet çdo vit;

dh) Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 2, nëpunësi doganor paraqet në DPD dokumentacionin e mëposhtëm:

i) kërkesë me shkrim, pranë njësisë buxhetore ku është i punësuar;

ii) fotokopje të kartës së identitetit, certifikatën e gjendjes familjare;

iii) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës ku është i transferuar;

iv) vërtetim nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se ai nuk ka banesë në juridiksionin ku është transferuar;

v) vërtetim nga ALUIZNI që nuk ka aplikuar për legalizim banese në juridiksionin ku është transferuar.

e) Titullari i njësisë shpenzuese verifikon, kur është rasti, nëpërmjet strukturave të varësisë, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe të zbatimit të kontratës së qirasë;

ë) Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të nëpunësit doganor, që nënkupton sistemimin me banesë në juridiksionin territorial të strukturës doganore ku ai bën pjesë;

f) Fondi i përcaktuar për pagesat e qirave për strehim planifikohet çdo vit në programin buxhetor të DPD-së.

8. Pas pjesës VIII, shtohet pjesa VIII/1, me këtë përmbajtje:

“VIII/1. Organizimi, funksionimi, struktura e administratës doganore dhe shpenzimet për kontrollet që kryhen pranë operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë shërbim.

1. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është 1 052 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor. Struktura organike dhe analitike e administratës doganore është sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

a) Organika e administratës doganore përbëhet nga:

i) Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

ii) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Doganave;

iii) Drejtori i kabinetit;

iv) Nëpunës, kategoria A;

v) Nëpunës, kategoria B;

vi) Nëpunës, kategoria C 1;

vii) Nëpunës, kategoria C 2;

viii) Punonjës administrativë, kategoria C 3;

ix) Punonjës administrativë, kategoria D 1;

x) Punonjës administrativë, kategoria D 2;

xi) Punonjës administrativë, kategoria D 3.

b) Funksionet dhe detyrat e personelit të administratës doganore janë, si më poshtë vijon:

i) Drejtori i Përgjithshëm i Doganave është kreu dhe struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare, që siguron administrimin e efektshëm të saj dhe drejton, bashkërendon e mbikëqyr veprimtarinë e administratës doganore dhe i raporton drejtpërdrejt ministrit të Financave për ecurinë e punës.

Përveç përgjegjësive të parashikuara në legjislacionin doganor, drejtori i Përgjithshëm i Doganave miraton planin strategjik operacional të biznesit të administratës doganore, planin e menaxhimit të ndryshimeve në biznes, propozon pranë ministrit të Financave strukturën organizative dhe rregulloren e brendshme të administratës doganore si dhe zbaton strategjitë e adreson përgjegjësitë në të gjitha nivelet e administratës, në varësi të nevojave apo të rrethanave specifike.

Gjithashtu, drejtori i Përgjithshëm i Doganave miraton rregulloret specifike të funksionimit të drejtorive dhe degëve doganore si dhe akte të tjera të nivelit të tretë, si vendime, urdhra, udhëzime, etj., në varësi të nevojave të punës.

Për të siguruar administrimin efektiv dhe përmbushjen e misionëve, të kompetencave dhe detyrave funksionale të administratës doganore, drejtori i Përgjithshëm i Doganave bashkëpunon e bashkërendon punën nëpërmjet zëvendës-drejtorëve dhe drejtuesve që ka në varësi të drejtpërdrejtë.



ii) Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Doganave është drejtuesi i një departamenti që siguron administrimin e efektshëm si dhe drejton, bashkërendon punën e mbikëqyr veprimtarinë e kryer nga drejtoritë e departamentit që mbulon. Ai ushtron funksionet e kompetencat sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për këtë pozicion si dhe funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

Drejtori i kabinetit

- Asiston drejtpërdrejtë drejtorin e Përgjithshëm në hartimin e planeve të veprimit dhe i përçon ato në strategjinë institucionale;

- Së bashku me drejtorin e kabinetit të ministrit, koordinon prioritetet që do të ndikojnë te drejtori i Përgjithshëm;

- Asiston, lidhur me përgjigjet që do t'u dërgohen grupeve kryesore të interesit, të iniciuara nga drejtori i Përgjithshëm;

- Analizon kërkesat e marra, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën sesi do të veprohet, e këshillon prioritetet në lidhje me to dhe për burimet, të cilat mund t'i përmbushin;

- Orienton, organizon dhe harmonizon veprimtarinë në zyrën e drejtorit të Përgjithshëm, duke informuar e shpërndarë punën, në varësi të ekspertizës teknike të këshilltarëve;

- Kryen çdo detyrë të ngarkuar nga drejtori i Përgjithshëm.

iv) Nëpunës, kategoria A

Në këtë kategori përfshihen: këshilltarë, drejtorë drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, kryetarët e degëve doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Kakavijë, Shkodër dhe Rinas.

Nëpunësit e kësaj kategorie, me funksionin këshilltar, kryejnë funksione këshillimore si dhe mbështesin e ndihmojnë drejtorin e Përgjithshëm, sipas fushave specifike që mbulojnë, bashkërendojnë punën dhe bashkëveprojnë me strukturat e tjera.

Nëpunësit e tjerë të kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

v) Nëpunës, kategoria B

Në këtë kategori përfshihen: përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, përgjegjës sektori në degët doganore, kryetar i një Dege doganore që nuk është përfshirë në përcaktimin e shkronjës "iii", më sipër.

Nëpunësit e kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë punën, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

vi) Nëpunës, kategoria C 1

Në këtë kategori përfshihen: specialistë, auditues, përgjegjës zyre, komandant grupi /motovedete, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, dhe specialistë, financierë, përgjegjës turni, në degë doganore.

Nëpunësit e kësaj kategorie i ushtrojnë detyrat dhe funksionet e tyre në të gjithë administratën doganore, bazuar në funksionet dhe specifikat e strukturës ku ato veprojnë dhe në përputhje me legjislacionin e aktet normative në fuqi, si dhe kryejnë funksionet e përgjegjësitë e deleguara.

Nëpunësit, që ushtrojnë funksionet komandant grupi, përgjegjës zyre, përgjegjës turni/grupi, kanë për detyrë, gjithashtu, të sigurojnë bashkërendimin e punës dhe sigurimin e efektshmërisë në veprimtarinë e kryer nga zyra apo sektori/grupi të cilin drejtojnë/udhëheqin.

vii) Nëpunës, kategoria C 2

Në këtë kategori përfshihen: doganier/ klasifikim / vlerësim/ kontroll fizik/ skaner/ akcize/regjime /preferenca/përgjashtime, inspektor, specialist i nivelit të dytë, asistent laborant.

Nëpunësit e kësaj kategorie ushtrojnë funksione lidhur me gjithë veprimtarinë dhe procedurat doganore, kontrollet e mbikëqyrjen doganore në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë e deleguara.

viii) Punonjës administrative, kategoria C 3

Në këtë kategori përfshihen: arkivist, sekretar, doganier peshoreje/ pikë kontrolli/ antikontra-bande dhe përpunues informacioni.

Punonjësit e kësaj kategorie ushtrojnë funksione lidhur me administrimin e korrespondencës e të dokumentacionit si dhe ruajtjen e tij, me procedurat e peshimit, kontrollit doganor, mbrojtjen e sigurinë dhe me përpunimin e informacionit doganor, përdorimit të mjeteve apo pajisjeve, si dhe ushtrojnë funksionet dhe përgjegjësitë e deleguara.

ix) Punonjës administrative, kategoria D 1

Në këtë kategori përfshihen punonjësit ndihmës: magazinier, teknik marine/motorist, teknik mirëmbajtje, shofer.



Punonjësit e kësaj kategorie ushtrojnë funksione lidhur me ruajtjen e bazës materiale dhe furnizimin, kryerjen e shërbimeve të ndryshme teknike, sigurimin e lëvizjes së sigurt të personelit doganor.

x) Punonjës administrative, kategoria D 2

Në këtë kategori përfshihen punëtorë mirëmbajtjeje, të cilët janë punonjës të tjerë ndihmës, që ushtrojnë funksione lidhur me mirëmbajtjen e ambienteve të zyrave si dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes.

xi) Punonjës administrative, kategoria D 3

Në këtë kategori përfshihen punonjës që kryejnë shërbime sanitare në ambientet e punës.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përbëhet nga Departamenti Administrativ, Departamenti i Akcizës, Departamenti Teknik dhe Departamenti Operativ dhe Hetimor, struktura që varen drejtpërdrejt nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave (niveli qendror) dhe degët doganore (niveli vendor).

a) Departamenti Administrativ përbëhet nga këto drejtori:

i) Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, që përbëhet nga:

- Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Sektori i Trajnimeve dhe Etikës;
- Zyra e Sekretarit/Protokollit dhe Arkivit.

Kjo drejtori bashkëpunon me DAP-in, administron procedurat e rekrutimit të personelit doganor, emërimet, ngritjen në detyrë, zbatimin e masave disiplinore, shkarkimet nga detyra, administron transferimin e personelit brenda zyrave të administratës doganore, ngritjen e përkohshme në detyrë, lëshon kartat e shërbimit e të identitetit për personelin doganor dhe administron arkivin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Gjithashtu, harton programe bazë për trajnimin e personelit, organizon kurse, seminare dhe veprimtari të tjera trajnuese për personelin doganor, nga fushat kryesore, duke përfshirë caktimin e trajnimit të personelit, bashkërendon veprimtaritë trajnuese e të ndihmës teknike, që jepen nga administratat e huaja doganore dhe organizatat ndërkombëtare, kontrollon, në vijimësi, zbatimin e Kodit të Etikës në administratën doganore si dhe transparencën në deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave.

ii) Drejtoria e Burimeve Mbështetëse, që përbëhet nga:

- Sektori i Investimeve dhe Logistikës;
- Sektori i Njësisë së Prokurimit.

Kjo drejtori planifikon, në bashkëpunim me të gjitha departamentet, blerjet, ndërtimet dhe rindërtimet e mjediseve dhe blerjen e makinerive e të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë doganore, duke përfshirë kompjutera, mjete transporti, pajisje për laboratorin e doganës, uniformat e personelit dhe orenditë e zyrave; Realizon procedurat e blerjes, të qirave, në bashkëpunim me degët doganore dhe zyrat e tjera të interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi; Administron dhe mirëmban mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

iii) Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, përbëhet nga: sektorët e mëposhtëm, me përgjegjësitë kryesore, si më poshtë vijon:

- Sektori i Sistemeve dhe i Sigurisë;

Ky sektor ofron mbështetje operative dhe mirëmbajtjeje në nivel qendror e lokal, për të maksimizuar disponueshmërinë e infrastrukturës dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit; Ky sektor siguron kunsulencë dhe ndihmë të vazhdueshme teknike për stafin e teknologjisë së informacionit në degët doganore dhe ofron kornizat arkitektonike të ndërtimit të sistemit, për të maksimizuar efikasitetin në mjedisin e teknologjisë së informacionit e të komunikimit; Me anë të aplikimit të metodave të sigurisë e të kanaleve të komunikimit, ky sektor realizon integritetin dhe administrimin e sistemeve informatike, me qëllim mbrojtjen nga sulmet për dëmtimin e sistemeve të kompjuterizuara të administratës doganore shqiptare.

- Sektori i Zhvillimit

Ky sektor administron projektimin, zhvillimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit për t'u përdorur nga shërbimi doganor dhe biznesi, si dhe jep këshilla për planifikimin, projektimin, zhvillimin dhe implementimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të ardhmen. Gjithashtu, ai ofron zgjidhje për informatizimin e të gjitha proceseve të punës në administratë, duke përdorur programe të gatshme, duke integruar zgjidhje të ndryshme dhe duke zhvilluar (programuar) zgjidhje origjinale, atje ku është e nevojshme.

- Sektori i Zgjidhjeve dhe i Suportit

Ky sektor ofron angazhimin për biznesin,



menaxhimin e projekteve dhe shqyrtimin e aktiviteteve të teknologjisë së informacionit dhe është një pikë e vetme e hyrjes për biznesin, për shërbimet e ofruara nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit; Ky sektor ofron shërbimin Help Desk, me anë të e-mail-it ose telefonit për probleme të ndryshme që lindin gjatë përdorimit të sistemeve informatike doganore, delegon problemin në sektorët apo drejtoritë përkatëse, kur për zgjidhjen e tij kërkohet ndërhyrje më e specializuar, si dhe bashkërendon punën ndërmjet strukturave të përfshira në këto zgjidhje.

iv) Drejtoria Juridike, që përbëhet nga:

- Sektori i Legjislacionit;
- Sektori i Ankimimeve.

Kjo drejtori mbështet propozimet ligjore për çështje që kanë të bëjnë me fushën doganore apo të akcizës si dhe ndjek planin e përafrimit të legjislacionit doganor/akcizës me atë të BE-së; Jep këshillim ligjor për strukturat e tjera të departamenteve të administratës qendrore dhe degët doganore, me kërkesë të tyre, për raste specifike lidhur me çështje doganore apo të akcizës; Shqyrton ankimet administrative ndaj vendimeve të degëve doganore për pagesën e detyrimeve dhe/ose gjobave dhe ia paraqet për vendimmarrje drejtorit të Përgjithshëm të Doganave; Administron proceset gjyqësore ku palë është DPD-ja, në të gjitha shkallët e gjykimit; Jep ndihmë ligjore për proceset gjyqësore ku palë janë degët doganore.

b) Departamenti i Akcizës përbëhet nga drejtoritë, si më poshtë vijon:

i) Drejtoria Teknike e Akcizës, që përbëhet nga:

- Sektori i Autorizimeve;
- Sektori i Lehtësirave, Klasifikimit dhe Pullave Fiskale;
- Sektori i Pajisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike.

Kjo drejtori administron procedurat e autorizimit e të licencimit dhe lëshon autorizimet për magazinat fiskale dhe depozituesit e miratuar, autorizon/licencon pritësit e regjistruar, dërguesit e regjistruar dhe përfaqësuesit fiskalë.

Administron procedurën e lehtësirave fiskale lidhur me përjashtimet dhe rimbursimet nga detyrimet e akcizës si dhe lëshon autorizimet për përjashtim apo autorizon rimbursimet; Administron dhe trajton përditësimet e nevojshme dhe problematikat lidhur me çështjet e klasifikimit fiskal, administron, monitoron e bashkërendon të

gjitha procedurat e nevojshme, lidhur me pullat fiskale dhe kodet e sigurisë, si dhe trajton çështje të garancive; Përgjigjet për hedhjen dhe përditësimin e rregullave në sistemin informatik;

Kontrollon, saktëson apo përditëson normativat teknike në procesin e prodhimit; Kontrollon koeficientët e humbjeve dhe të firove; Kontrollon procedurat e shënimit fiskal dhe të ngjyritimit, si dhe pajisjet e instrumentet matëse, linjat teknologjike, depozitat, rezervuarët, kalibrimin e tyre etj.

ii) Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit, që përbëhet nga:

- Sektori i Pijeve Alkoolike;
- Sektori i Produkteve Energjetike;
- Sektori i Produkteve të Tjera.

Kjo drejtori kryen mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin sipas produkteve specifike të magazinave fiskale të prodhimit apo stokimit, kontrollon dhe monitoron lëvizjen e produkteve të akcizës nën pezullim, monitoron zbatimin e kushteve si dhe respektimin, nga operatorët e akcizës, të skemës së përjashtimeve dhe rimbursimeve; Bashkëpunon me strukturat e tjera qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas rastit, për trajtimin e operacioneve të parregullta; Kryen analizime të ndryshme, përfshirë edhe ato aposteriori lidhur me importimin, prodhimin, stokimin dhe lëvizjen e produkteve të akcizës, sipas llojit të tyre.

Kjo drejtori harton projekte dhe përditëson metodikat për kontrollin e magazinave fiskale, depozituesit e miratuar, pritësit dhe dërguesit e regjistruar, si dhe të proceseve të ndryshme të prodhimit të mallrave të akcizës, harton dhe përditëson metodikat lidhur me matjen e produkteve dhe depozitave, rezervuarëve etj., sipas produkteve specifike.

c) Departamenti Teknik përbëhet nga drejtoritë, si më poshtë vijon:

i) Drejtoria e Procedurave Doganore, që përbëhet nga:

- Sektori i Procedurave dhe Regjimeve Doganore;
- Sektori i Lehtësive, Thjeshtimeve Doganore dhe Transitit;
- Sektori i Harmonizimit të Procedurave Doganore dhe Informimit të Operatorëve.

Kjo drejtori, në përputhje me dispozitat në fuqi, administron dokumentacionin për lëvizjen e mallrave e të bagazheve brenda territorit doganor



të Republikës së Shqipërisë, deklaratat përmbledhëse, dokumentet për magazinimin e përkohshëm të mallrave dhe për deklarimin doganor, lehtësimin dhe thjeshtimin e procedurave doganore; Administron procedurat doganore dhe lëshimin e autorizimeve për to, si dhe për agjentët doganorë; Administron dokumentet për turizmin ndërkombëtar, procedurat e vendosjes në qarkullim të lirë dhe të eksportit, procedurat e transitit, të përpunimit aktiv dhe pasiv, të përpunimit nën kontroll doganor, të lejimit të përkohshëm, procedurat e magazinimit doganor, zonat e lira dhe magazinat e lira; Administron dokumentet për magazinat e furnizimit dhe “Duty Free Shops”, furnizimet dhe pajisjet për përdorim në bord të mjeteve të transportit, për ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e mallrave me karakter fito-sanitar; Administron rregullat si dhe procedurat e lehtësimit dhe thjeshtimit, si zhdoganimin lokal, OEA, kompetencat territorial, etj.; Jep udhëzimet e nevojshme për përdoruesit në lidhje me sistemet e të dhënave, të formularëve, të regjistrave dhe të blloqeve përkatëse, të nevojshme në lidhje me procedurat doganore; Informon operatorët ekonomikë për procedurat doganore, lehtësitë dhe thjeshtimet që ofron legjislacioni doganor; Harmonizon udhëzimet apo aktet e tjera të nivelit të tretë me Kodin Doganor.

ii) Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, që përbëhet nga:

- Sektori i Tarifës;
- Sektori i Origjinës.

Kjo drejtori harton e përditëson nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore si dhe administron shënimet (notat) shpjeguese, jep informacion tarifor të detyrueshëm (ITD), administron operacionet e privileguara, mbikëqyr rregullat për taksat e tjera në import; mbikëqyr rregullat për TVSH-në në import.

Gjithashtu, kjo drejtori administron origjinën e mallrave, sipas marrëveshjeve preferenciale përkatëse, procedurat e lëshimit të certifikatave të origjinës preferenciale, ndjek zbatimin e masave të politikës tregtare, të kuotave e të tavaneve tarifore dhe të masave antidumping.

iii) Drejtoria e Laboratorit Doganor, që përbëhet nga:

- Sektori i Standardeve, Metodikave dhe Administrimit;
- Sektori i Analizave;

- Sektori i Klasifikimit Tarifor.

Kjo drejtori kryen studime për metodat dhe teknikat për analizën kimike, teknologjike e mercologjike të mallrave; Analizon mostrat e marra nga zyrat vendore; Lëshon certifikatat përkatëse për verifikimin e llojit të mallrave, të emërimit të tyre dhe bën klasifikimin tarifor; Administron dhe mirëmban pajisjet e Laboratorit Doganor.

iv) Drejtoria e Vlerës Doganore, që përbëhet nga:

- Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore;
- Sektori i Metodologjisë së Vlerësimit Doganor.

Kjo drejtori administron dispozitat që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit doganor të mallrave e shërbimeve si dhe ndjek përditësimin e kursit të këmbimit; Përgatit e administron udhëzimet dhe urdhrat që kanë të bëjnë me metodologjinë e vlerësimit, për qëllime doganore;

Në bashkëpunim me degët doganore dhe strukturat e tjera të administratës doganor, kjo drejtori mbikëqyr zbatimin e metodologjisë së vlerësimit doganor të mallrave;

Kjo drejtori, mbështetur në burime të miratuara, përditëson “dosjen” me të dhënat e disponueshme si dhe me sisteme apo mekanizma të tjera, për qëllim të vlerësimit doganor të mallrave.

ç) Departamenti Operativ dhe Hetimor përbëhet nga drejtoritë, si më poshtë vijon:

i) Drejtoria e Antikontrabandës, që përbëhet nga:

- Sektori i Antikontrabandës Tokësore;
- Sektori i Antikontrabandës Detare.

Kjo drejtori kryen kontrole fizike dhe dokumentare, në bazë të planeve operacionale, të dhënave dhe analizës së riskut, në çdo ambient, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke kontrolluar apo shqyrtuar mallrat, personat dhe mjetet e transportit, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e kontrabandës, të prodhimit dhe tregtimit të paligjshëm të mallrave të akcizës dhe të kundërvajtjeve administrative, brenda territorit doganor shqiptar dhe nga/apo drejt territorit të vendeve të tjera; Nëpërmjet kryerjes së kontroleve, identifikon dhe jep të dhëna rreth veprimtarisë ose personave të dyshimtë për data-base-in e informacionit, jep ndihmë në hetimin e shkeljeve të rënda doganore dhe të akcizës. Gjithashtu, kjo drejtori mbështet degët doganore për vjeljen e borxhit dhe rikuperimin me forcë.



ii) Drejtoria e Hetimit.

Kjo drejtori ndërmerr hetime për shkelje të dyshuara apo të vërejtura nga drejtoria e antikontabandës, drejtoria e informacionit si dhe nga struktura të tjera, brenda dhe jashtë sistemit doganor, me kërkesë të tyre apo me iniciativë. Gjithashtu, kjo drejtori mbledh të dhëna, përgatit kallëzime penale për në organin e prokurorisë, jep dokumentacion, harton raporte dhe praktika në ndihmë të këtij organi.

iii) Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, që përbëhet nga:

- Sektori i Monitorimit;
- Sektori i Analizës së Riskut.

Kjo drejtori siguron bashkërendimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin 24-orësh të mjedisve dhe punës në terren në degët doganore të veprimtarisë së strukturave të Departamentit Operativ Hetimor;

Menaxhon mbledhjen e të dhënave për shkeljet doganore të dyshuara, faktike apo të mundshme, përgatitjen, monitorimin dhe analizën e riskut, me qëllim rritjen e eficiencës së kontrolleve doganore dhe ushtrimin e kontrolleve me bazë indikatorët e riskut. Bashkëpunon me strukturat e tjera doganore dhe me institucione të tjera në ushtrimin e funksioneve që kryen.

iv) Drejtoria e Informacionit, që përbëhet nga:

- Sektori i Inteligjencës Operative;
- Sektori i Përpunimit të Informacionit;
- Sektori i Shkëmbimit të Informacionit.

Kjo drejtori mbledh të dhëna për shkeljet doganore apo të akcizës të dyshuara, faktike apo të mundshme; Kryen kërkime, duke shfrytëzuar marrëveshjet e asistencës administrative, të nënshkuara me administratat doganore të vendeve të tjera; Kryen përpunimin e informacionit për përgatitjen e raporteve inteligjente dhe cilësore, duke propozuar veprime të mëtejshme nga struktura brenda institucionit apo dhe jashtë tij; Përpunon informacionin e grumbulluar nga burime të ndryshme dhe analizon të dhënat për veprimtaritë ose personat e dyshimtë, si dhe furnizon, periodikisht, me produkte inteligjence, drejtorin e Përgjithshëm të Doganave.

v) Drejtoria e Kontrollit pas Zhdoganimit, që përbëhet nga:

- Sektori i Kontrollit të Vlerës, Klasifikimit, Origjinës;
- Sektori i Kontrollit të Regjimeve Doganore.

Kjo drejtori ndërmerr kontrole dokumentare dhe fizike, pas çlirimit të mallrave, për të verifikuar të gjithë dokumentacionin tregtar dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me veprimet doganore të operatorëve ekonomikë dhe veprimet e mëtejshme tregtare, të cilat kanë të bëjnë me këto mallra; Këto kontrole bëhen pranë mjedisve të operatorëve ekonomikë, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimet doganore, si dhe nëpërmjet rishqyrtimit të praktikave doganore, brenda sistemit doganor.

Gjithashtu, me nismën e vet apo me kërkesën e operatorëve ekonomikë, ndërmerr rishikimin dhe verifikimin e saktësisë së të dhënave të deklaratës doganore si dhe përpunon e analizon, nëpërmjet teknikave të menaxhimit të dhënave të siguruar nga strukturat e tjera të administratës doganore e administratave homologe.

vi) Drejtoria e Antitrafikut

Kjo drejtori ka si objekt të veprimtarisë së saj zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, veçanërisht në funksion të përmbushjes së misionit mbrojtës për sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Veprimtaria e Drejtorisë Antitrafik lidhet me organizimin e mbikëqyrjes së kufirit shtetëror nga strukturat e shërbimit doganor që operojnë në kufi, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve të mallrave, mjeteve të transportit dhe të subjekteve, për parandalimin e trafikeve të paligjshme, përfshirë parandalimin e pastrimit të parave, kontrollit të transferimit fizik të valutës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit. Drejtoria Antitrafik mund të shkëmbejë të dhëna me struktura të tjera doganore apo shtetërore, me kompetenca në fushën e zbatimit të ligjit, për mallra, mjete apo subjekte, me qëllim parandalimin dhe goditjen e shkeljeve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi kundër trafikeve. Ajo bashkëpunon me agjenci, institucione dhe aktorë të tjerë, përfshirë ata ndërkombëtarë, të cilët kanë detyrime ligjore ose që janë të angazhuar në luftën kundër trafikeve dhe zbatimin e masave ndaluese, kufizuese.

vii) Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale

Kjo drejtori ka për detyrë, administrimin e procedurave për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (pronësinë industriale dhe pronësinë intelektuale) për mallrat që hyjnë/dalin nga territori shqiptar, me kërkesë të mbajtësve të së drejtës ose me iniciativën dhe administrimin e



kërkesave për veprim në kuadër të mbrojtjes së pronësisë intelektuale.

d) Struktura që varen drejtpërdrejt nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave janë, si më poshtë vijon:

i) Zyra e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave

Kjo zyrë koordinon, mbështet, ndihmon dhe këshillon drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, lidhur me:

- prioritetet që do ndikojnë në funksionet e drejtorit të Përgjithshëm;

- analizimin e kërkesave të marra dhe kontrollin e përgjigjeve që u dërgohen grupeve kryesore të interesit, të iniciuara nga drejtori i Përgjithshëm;

- hartimin e planeve të punës dhe Strategjinë Institucionale;

- orientimin, organizimin dhe harmonizimin e veprimtarisë në Zyrën e drejtorit të Përgjithshëm;

- koordinimin për çështjet që lidhen me elementet teknike dhe procedurale, zbatimin e projekteve, në të cilat përfituese është administrata doganore, dhe stimulimin e shtimit të nivelit të asistencës, vlerësimin dhe përmirësimin e elementeve të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe, kryesisht, komunitetin e biznesit lidhur me risitë, nismat dhe zhvillimet e administratës doganore;

- ndjekjen e problemeve të përditshme, sipas detyrave të përcaktuara nga drejtori i Përgjithshëm;

- mbështetjen dhe ndihmën e drejtorit të Përgjithshëm për formulimin e zbatimit të planeve të veprimit, strategjive, sipas detyrave të institucionit, si dhe sigurimin e lidhjeve organike me strukturat organizative, komunitetin e biznesit dhe institucionet e tjera, qendrore e vendore.

ii) Drejtoria e Auditit të Brendshëm

Kjo drejtori ushtron auditimin e përgjithshëm të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, verifikon saktësinë e zbatimit të procedurave administrative të kryera nga personeli doganor dhe përgatit raporte për drejtorin e Përgjithshëm ose, kur është e nevojshme, për komisionin disiplinor.

iii) Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritet Evropian

Kjo drejtori përgatit, në bashkëpunim me strukturat e tjera, marrëveshjet e asistencës administrative dypalëshe për çështje doganore si dhe protokollet e bashkëpunimit me këto administrata; Ndjek e menaxhon marrëdhëniet me administratat doganore të vendeve të tjera dhe me

partnerët e huaj, brenda dhe jashtë vendit; Përgatit, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të DPD-së, sipas rastit, dokumentacionin e nevojshëm si dhe aplikon për t'u bërë pjesë dhe/ose për të përfituar nga programe a projekte asistence, të ofruara nga organizmat e BE-së apo nga institucionet, organizmat dhe struktura të tjera, bazuar në nevojat dhe kërkesat e administratës doganore; Menaxhon projektet e ndryshme të financuara plotësisht apo pjesërisht nga BE-ja ose nga organizma/struktura të tjera, përfituese e të cilave është administrata doganore; Organizon vizita të delegacioneve doganore të huaja në Republikën e Shqipërisë dhe të delegacioneve të doganës shqiptare jashtë; administron pjesëmarrjen e personelit të administratës doganore në veprimtari të ndryshme jashtë vendit; kryen shërbime përkthimi për nevojat e administratës doganore; Ndjek dhe menaxhon marrëdhëniet me massmedian dhe me komunitetin e biznesit, si dhe përgatit e ndjek zbatimin e programeve të publikimit të çdo risie në sistemin doganor; Bashkërendon punën me strukturat respektive dhe, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të DPD-së, përgatit, sipas rastit, raportet periodike dhe informacionet e nevojshme, në kuadër të integritetit në BE.

iv) Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale

Kjo drejtori heton shkeljet për raste të mundshme korrupsioni të denoncuar nga qytetarë, operatorë ekonomikë apo bazuar në informacione të ardhura nga sektorë të tjerë, brenda institucionit apo jashtë tij. Gjithashtu, ajo nxjerr përgjegjësitë për rastet konkrete dhe marrjen e masave të nevojshme, jep kontribut për përmirësimin e disiplinës në punë dhe të rregullave të etikës në përgjithësi. Me qëllim rritjen e standardeve profesionale, implementon testin e integritetit dhe metodën e dokumentimit të standardizuar.

v) Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, që përbëhet nga:

- Sektori i Planifikim - Monitorimit të Buxhetit;

- Sektori i Financë - Kontabilitetit;

- Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave.

Sektori i Planifikim - Monitorimit të Buxhetit ndjek zbatimin e legjislacionit dhe të procedurave që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe buxhetin e financave publike, organizimin e punës në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm të



institucionit, hartimin e pasqyrave përmbledhëse të projektbuxhetit si dhe detajimin e planit të buxhetit të miratuar nga Ministria e Financave për Aparatin e Drejtorisë dhe Degët Doganore; Hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit dhe raportimin e tyre pranë Ministrisë së Financave, brenda afateve të përcaktuara; Rakordimin, me Ministrinë e Financave, të fondeve buxhetore të planifikuara dhe të realizuara; monitorimin rregullisht të transfertave nga gjodat në dispozicion të Drejtorisë Përgjithshme si edhe përdorimin e tyre për pjesën e shpenzimeve operative e investimeve si dhe fondin për shpërblimin nga gjodat, konform Kodit Doganor dhe udhëzimeve përkatëse për këtë qëllim.

Sektori Financë – Kontabilitet kryen analizat financiare dhe të bilancit, mbajtjen e kontabilitetit, shpërndarjen dhe dhënien e fondeve të nevojshme për funksionimin e zyrave qendrore e vendore, pagimin e personelit doganor dhe administrimin e pagave e të shpërblimeve të tjera shtesë të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme; Ndjek kontrollin dhe monitorimin e të gjitha pagesave në sistem, përgatitjen e procedurave të kreditimit të pagesave dhe të kontrollit të tyre me bankat e thesarin; Ndjek përgatitjen e raporteve periodike për kreditë dhe debitë e trashëguara.

Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave monitoron pagesat hyrëse në sistemin *Asycuda World* që të bëhen në mënyrë standarde; Siguron që pagesat të bëhen në numrin e llogarisë që i përket shoqërisë; Ndjek dhe evidenton të gjitha pasaktësitë e arkëtarëve të degëve doganore në lidhje me pagesat hyrëse në sistem; Administron rregullat dhe procedurat e dhënies së garancive doganore e të akcizës, të monitorimit dhe të zhbllokimit të tyre; Përgatit raportet përkatëse në lidhje me shumat e kredituara në sistemin *Asycuda World* gjatë periudhës dhe bën përpunimin e këtyre raporteve; Përgatit informacionin përfundimtar në lidhje me krahasimin e shumave të kredituara në sistem, me ato të marra nga thesari dhe të dhënat e dërguara nga çdo degë doganore; Sigurohet që të marrë periodikisht, nga Ministria e Financave, në format elektronik dhe në periudha njëmuajore, informacion të detajuar nga thesari në lidhje me pagesat e bëra për shkak të veprimtarisë doganore.

vi) Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave, që përbëhet nga:

- Sektori i Monitorimit të të Ardhurave, Analizave dhe Statistikës;

- Sektori i Monitorimit të Borxhit.

Kjo drejtori ka për detyrë mbledhjen e të dhënave për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, monitorimin dhe detajimin e planit të të ardhurave, analizimin e të dhënave objekt të vlerësimit nga zyrat e interesuara dhe autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke e zgjeruar fushën e përgjegjësisë edhe me studime e analiza të realizimit të të ardhurave dhe mallrave kryesore.

Gjithashtu, kjo drejtori administron procedurat për regjistrimin e operatorëve në sistemin doganor, lindjen dhe rikuperimin e borxhit, përgatitjen dhe administrimin e udhëzimeve për kontabilizimin e të ardhurave nga detyrimet e importit, eksportit ose akcizës, për vjeljen e detyrimeve dhe rimbursimin ose shlyerjen e borxhit, si dhe monitoron procedurat për rikuperimin dhe vjeljen me forcë të borxhit.

dh) Degët doganore.

i) Degët doganore janë të vendosura në: Shkodër, Lezhë (Shëngjin), Kukës (Morinë), Peshkopi (Blladë), Tiranë (Vorë), Krujë (Rinas), Durrës, Elbasan, Pogradec (Qafë Thanë), Korçë, Kapshticë (Devoll), Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë (Kakavi), Sarandë (Qafë Botë) dhe Përmet (Tri Urat).

ii) Degët doganore përbëhen nga një ose disa zyra doganore, sipas aneksit 1. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me udhëzim, përcakton mbulimin territorial të degëve doganore.

iii) Degët doganore mund të organizohen, në varësi të funksioneve që kryejnë dhe të vëllimit të punës, në këta sektorë:

- Analiza e riskut dhe e kontrolleve pas zhdoganimit;

- Çështje të përgjithshme;

- Pranimi, pika e kontrollit, peshimi;

- Zyra e kontrolleve dokumentare dhe fizike;

- Regjimet, akciza, origjina, përjashtimet;

- Zyra e skanerit.

iv) Degët doganore kanë si detyra kryesore:

- zbatimin e legjislacionit doganor dhe të akcizës, legjislacionin lidhur me ndalimet dhe



kufizimet si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë doganore, procedurat e kontrollit dhe të mbikëqyrjes;

- vjeljen e detyrimeve që duhen paguar në doganë;

- parandalimin, konstatimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara;

- parandalimin, konstatimin, verifikimin e kundërvajtjeve të parashikuara nga legjislacioni doganor dhe i akcizës;

- mbikëqyrjen, në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore;

- mbrojtjen e interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe çdo mbrojtje tjetër të ngarkuar, sipas legjislacionit në fuqi dhe misionit të administratës doganore.

3. Shpenzimet për kontrollet që kryhen pranë operatorëve ekonomik të interesuar për këtë shërbim

a) Në raste specifike, kur nga operatori ekonomik paraqitet aplikim (kërkesë) për shërbime që kërkojnë prezencë të vazhdueshme të punonjësve doganorë pranë ambienteve të tyre, dhe në kushtet kur, për shkak të numrit të kufizuar të punonjësve, autoritetet doganore nuk mund të ushtrojnë shërbimet pranë këtij operatori gjatë gjithë orarit të punës, të kërkuar prej këtij të fundit, administrata doganore mund të ofrojë shërbime përkundrejt pagesës.

Për këtë qëllim, pranë administratës doganore, mund të punësohet/en punonjës jashtë strukturës së miratuar për administratën doganore, me kusht që operatori ekonomik kërkues në fjalë të marrë përsipër pagesat për të gjitha shpenzimet e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, pa kufizuar detyrimet e tjera ligjore, ku përfshihen paga mujore e punonjësit për gjithë periudhën e kërkuar të shërbimit, tatimi mbi të ardhurat mbi pagën, sigurimet shoqërore, sipas raporteve aktuale të kontributit, pagesa e lejes së zakonshme, pagesa për pajisjen me uniformë personeli doganor, pagesa e sigurimeve shëndetësore, sipas raporteve aktuale të kontributit, etj. Shpenzimet e sipërpërmendura për një punonjës të rekrutuar do të jenë të barabarta me nivelin aktual të pagesës si dhe të kontributeve të kategorisë respektive, që kërkohet për punonjësit e tjerë doganorë, të emëruar për natyrën dhe llojin e vendit të punës.

b) Operatori ekonomik i interesuar duhet të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave një kërkesë me shkrim si dhe duhet të nënshkruajë një kontratë specifike për këtë qëllim, në plotësim të kërkesave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “c”, nëpërmjet së cilës merr përsipër pagesën për shërbimin e kërkuar.

c) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me miratimin e kërkesës së operatorit ekonomik, nënshkruan kontratën me këtë të fundit për fillimin e rekrutimit të punonjësve për këtë qëllim. Kontrata duhet të jetë për një afat jo më pak se 1-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje. Palët mund ta zgjidhin këtë kontratë për çfarëdo arsye, duke bërë një njoftim, së paku 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj. Në rast se palët, në përfundim të kohës së vlefshmërisë së saj, nuk kanë kontestime, atëherë kontrata do të konsiderohet si e lidhur edhe për një vit tjetër, e kështu në vijimësi. Në rast të heqjes dorë nga autorizimi respektiv i autoriteteve doganore apo i Ministrisë së Financave prej operatorit ekonomik apo revokimit ose, në rast anulimi të këtyre të fundit, kontrata në fjalë do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur.

ç) Menjëherë me nënshkrimin e kontratës së sipërpërmendur, administrata doganore fillon procedurat e rekrutimit të punonjësit/ve, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur dhe në vijimësi, për gjithë periudhën e punësimit, zbatohen të gjitha dispozitat ligjore e nënligjore, sipas të cilave rregullohen marrëdhëniet e punës së personelit doganor. Me përfundimin e procedurës së rekrutimit për këta punonjës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton, për këtë qëllim, përveç strukturave të saj, edhe operatorin ekonomik kërkues. Administrimi i procedurave të sipërpërmendura kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

d) Në rast të kërkesës për ndërprerje apo prishje të kontratës nga operatori ekonomik, menjëherë me marrjen e kësaj të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të njoftojë punonjësin e rekrutuar se do të zgjidhen marrëdhëniet e punës ose, në rast se ka vende të lira pune brenda administratës doganore, mundet t'i ofrohet vendi i lirë. Në rast se vendi i ri i punës, i propozuar, pranohet nga punonjësi i rekrutuar, atëherë ai transferohet në pozicionin e ri të punës pa iu nënshtruar procedurave të tjera të rekrutimit.



dh) Me qëllim garantimin e pagesës korrekte të punonjësve të rekrutuar, të gjitha shpenzimet tremujore (tërësia e pagesave të nevojshme) të sipërpërmendura do të parapagohen (derdhen) nga operatori ekonomik i interesuar në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pranë Degës së Thesarit Tiranë, jo më vonë se data 25 e çdo tremujori, duke filluar që nga tremujori në të cilin bëhet efektive kontrata e punësimit, dhe do të përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara në këtë pikë.

e) Në rast se shpenzimet nuk parapagohen në llogarinë e sipërpërmendur, atëherë operatori ekonomik paralajmërohet se do t'i ndërpritet menjëherë shërbimi, sipas intervalit kohor të kërkuar prej tij. Nëse pagesa nuk kryhet brenda një afati 10-ditor, pas afatit të pagesës së përcaktuar më lart, atëherë kontrata do të konsiderohet e zgjidhur. Çdo e ardhur e ofruar nga operatorët ekonomikë për këtë shërbim konsiderohet si e ardhur jashtë limitit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

ë) Për të shmangur konfliktin e interesit dhe garantimin e paanësisë së shërbimit nga autoritetet doganore, punonjësit doganorë të rekrutuar sipas procedurave të mësipërme nuk do të jenë të vendosur pranë operatorëve ekonomikë kërkues të shërbimit, por në struktura të tjera të shërbimit doganor. Shërbimi pranë këtyre operatorëve do të mundësohet nga punonjësit doganorë, pjesë e strukturës organike të administratës doganore.

f) Në rastet kur operatori paraqet kërkesë për shërbime doganore apo që kërkojnë prezencë periodike të punonjësve doganorë pranë ambienteve të tyre një apo disa herë gjatë vitit, administrata doganore mund të ofrojë shërbime doganore përkundrejt pagesës së tarifave të përcaktuara nga Ministria e Financave, e cila merr

në konsideratë koston e plotë të këtij shërbimi. Kjo tarifë bazohet në përcaktimet e legjislacionit të punës për këtë qëllim dhe merr në konsideratë orët e punës, shpenzimet e transportit dhe shpenzime të tjera për kryerjen e shërbimit.”

9. Pjesa X riformulohet, si më poshtë vijon:

“X. Shfuqizime

1. Nenet 3–9, 11–13 dhe 16–19, të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Në pikën 6, të nenit 15, të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, fjalitë “...Kontrollet fizike dhe ato dokumentare nuk mundet të kryhen nga i njëjti doganier. Doganieri përgjegjës për kontrollet fizike, në rastet kur konsiderohet e nevojshme për verifikime doganore, mundet të marrë mostra për t'i dërguar për analiza pranë Laboratorit Kimik Doganor...”, ndryshojnë, me këtë përmbajtje:

“...Kontrollet fizike dhe dokumentare kryhen në përputhje me analizën e riskut. Doganieri përgjegjës, në rastet kur konsiderohet e nevojshme për verifikime doganore, mund të marrë mostra për t'i dërguar për analizim pranë Laboratorit Doganor...”.

10. Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrin të gjitha masat dhe të kryejnë të gjitha procedurat për plotësimin e vendeve të punës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKSI NR. 1

0	Emërtimi i postit	Funksioni	Kateg	Nr. i punonjësve	Kategoria e pagës
Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm		Drejtor i Përgjithshëm		1	II-a
		Këshilltar për Çështjet Teknike	A	1	III-a
		Drejtor Kabineti		1	III-a
		Këshilltar	A	3	III-a
		Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm	C3	1	
Totali i Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm				7	
Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimin Evropian		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Specialist	C1	4	III-b
Totali drejtorisë				5	
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Audites	C1	7	III-b
Totali drejtorisë				8	
Drejtoria e Antikorupsionit dhe Standardeve Profesionale		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Specialist	C1	4	III-b
Totali drejtorisë				5	
Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave	Sektori i Monitorimit të të Ardhurave, Analizave & Statistikës	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Sektori i Monitorimit të Borxhit	Specialist	C1	4	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
Totali drejtorisë				9	
Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës	Sektori Planifikim-Monitorim Buxheti	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori Financë - Kontabilitet	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	Magazininier	D1	2	
Përgjegjës sektori		B	1	III-a/1	
		Specialist	C1	6	III-b
Totali drejtorisë				16	
Totali i Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtorive në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm				50	
Departamenti Teknik		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Sekretar	C3	1	
Total				2	
Drejtoria e Procedurave Doganore		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përpunues informacioni	C3	1	
	Sektori i Harmonizimit të Procedurave Doganore dhe Informimit të Operatorëve	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i Procedurave dhe Regjimeve Doganore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
Sektori i Lehtësive, Thjeshtimeve Doganore dhe Transitit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Specialist	C1	2	III-b	
Totali drejtorisë				13	
Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës	Sektori i Tarifës	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Sektori Origjinës	Specialist	C1	4	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	3	III-b
Totali drejtorisë				10	
Drejtoria e Laboratorit Doganor		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
	Sektori Standardeve, Metodikave dhe Administrimit	Përpunues informacioni	C3	1	
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Sektori i Klasifikimit Tarifor	Specialist laborante	C1	2	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	3	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Sektori i Analizave	Specialist laborante	C1	3	III-b	
	Asistentë laborante	C2	6	IV-a	
Totali drejtorisë				20	
Drejtoria e Vlerës Doganore	Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Sektori i të Dhënave të Disponueshme	Specialist	C1	2	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
Totali drejtorisë				7	
Totali i Departamentit Teknik				52	
Departamenti i Akcizës		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Sekretar	C3	1	
Total				2	
Drejtoria Teknike e Akcizës	Sektori i Autorizimeve	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b



	Sektori i Aplikacioneve	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
		Specialist	C2	1	IV-a
	Sektori i Pajisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Totali drejtorisë			13	
Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Pijeve Alkoolike	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Sektori i Produkteve Energjetike	Specialist	C1	4	III-b
		Specialist GFI	C2	5	IV-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Sektori i Produkteve të Tjera	Specialist	C1	2	III-b	
	Totali i drejtorisë			19	
Totali i Departamentit të Akcizës				34	
Departamenti Operaiv Hetimor		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Sekretar	C3	1	
Total				2	
Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit (Aposterior)		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Kontrollit të Vlerës, Klasifikimit, Origjinës	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Kontrollit të Regjimeve Doganore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Totali drejtorisë			11	
Drejtoria e Antikontrabandës	Sektori i Antikontrabandës Tokësore	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Komandant grupi	C1	18	III-b
		Inspektor	C2	32	IV-a
		Doganier Pike Kontrolli	C3	8	
	Sektori i Antikontrabandës Detare	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Komandant Grupi	C1	4	III-b
		Specialist	C1	1	III-b
		Specialist i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare	C1	4	III-b
		Inspektor	C2	13	IV-a
		Magaznier	D1	1	
	Teknik marine/motorist	D1	5		
	Totali drejtorisë			89	
Drejtoria Antitrafik		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Specialist	C1	7	III-b
	Totali drejtorisë			8	
Drejtoria e Hetimit		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përpunues informacioni	C3	1	
		Specialist	C1	14	III-b
		Oficer të Policisë Gjyqësore		8	
	Totali drejtorisë			24	
Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Specialist	C1	4	III-b
	Totali drejtorisë			5	
Drejtoria e Informacionit		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Perfaqësues ne SECI	A	1	III-a
	Sektori i Inteligjencës Operative	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	8	III-b
	Sektori i Përpunimit të informacionit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	3	III-b
	Sektori i Shkëmbimit të Informacionit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Specialist	C1	5	III-b	
	Totali drejtorisë			21	
Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit	Sektori i Monitorimit	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	13	III-b
	Sektori i Analizës së Rikut	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	6	III-b
	Totali drejtorisë			22	
Totali Departamentit Operativ Hetimor				182	
Departamenti Administrativ		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Sekretar	C3	1	
Total				2	
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Trajnimeve dhe Etikës	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Zyra e Sekretari/Protokollit dhe Arkivit	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Sekretar/Protokollit	C3	2	
		Arkivist	C3	2	
	Totali drejtorisë			14	



	Drejtoria e Burimeve Mbështetëse	Sektori i Investimeve & Logjistikës	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist	C1	5	III-b	
			Përpunues informacioni	C3	1		
			Teknik mirëmbajtje	D1	1		
			Teknik mirëmbajtje (Oficina)	D1	3		
			Shofer	D1	12		
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	5		
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Specialist	C1	2	III-b			
	Totali drejtorisë					32	
	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit	Sektori i Sistemeve dhe Sigurisë	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist	C1	5	III-b	
		Sektori i Zhvillimit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
Specialist			C1	5	III-b		
Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk)	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1			
Specialist	C1	5	III-b				
Totali drejtorisë					19		
Drejtoria Juridike	Sektori i Legjislacionit	Drejtor drejtorie	A	1	III-a		
		Përpunues informacioni	C3	1			
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
	Sektori i Ankimeve	Specialist	C1	4	III-b		
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
Specialist	C1	7	III-b				
Totali drejtorisë					15		
Totali i Departamentit të Administrativ					82	0	
Totali i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave					400	0	
1	Dega Doganore Shkodër	Administrata	Kryetar Dogane	A	1	III-a	
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b	
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b	
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b	
			Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1		
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	3	IV-a	
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përgjashtime	C2	5	IV-a	
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Pikë Kontrolli	C3	2		
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	9	IV-a	
		Zyra Doganore Hani i Hotit	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	9	IV-a	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a	
		Zyra Doganore Bajzë	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a	
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
		Zyra Doganore Murriqan	Doganier Pikë Kontrolli	C3	4		
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a	
			Punëtor mirëmbajtje	D2	1		
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
		Zyra Doganore Vermosh	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2		2	IV-a			
Totali Degës Doganore					47		
2	Dega Doganore Lezhë	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1	
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b	
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b	
			Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1		
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2		
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a	
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik për karburantet	C2	2	IV-a	
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përgjashtime	C2	3	IV-a	
Totali Degës Doganore					19		
3	Dega Doganore Bllatë (Peshkopi)	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1	
			Specialist Analize Risku /Aposterior/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b	
			Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1		
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	3		
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a	
Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përgjashtime	C2	3	IV-a			
Totali Degës Doganore					18		



4	Dega Doganore Kukës (Morinë)	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
			Përgjegjës Zyre	C1	4	III-b
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	6	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
		Zyra e Skanerit	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përfashtime	C2	3	IV-a
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
		Zyra Doganore Qafë Prush	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
Pika Doganore Shishtavec	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2			
	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b		
Zyra Doganore Qafë Morinë Tropojë	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	3	IV-a		
	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b		
Totali i Degës Doganore				49		
5	Dega Doganore Tiranë	Administrata	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku	C1	1	III-b
			Specialist Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	4	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Specialist finance	C2	1	IV-a
			Sekretar	C3	1	
			Arkivist	C3	2	
			Magazinier	D1	1	
		Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
		Spektori i Operacioneve Doganore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Zyra Peshore/Pikë Kontrolli	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	8	
Zyra e Akcizës	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b		
	Doganier Akcize	C2	9	IV-a		
Zyra Klasifikim/Vlerësim/Kontrolli Fizik	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b		
	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	19	IV-a		
Zyra Regjime/Preferenca/Përfashtime	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b		
	Doganier Regjime/Preferenca/Përfashtime	C2	9	IV-a		
Totali i Degës Doganore				65		
6	Dega Doganore Durrës	Administrata	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku	C1	1	III-b
			Specialist Aposterior	C1	2	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	5	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Specialist finance	C2	1	IV-a
			Sekretar	C3	1	
			Arkivist	C3	3	
			Magazinier	D1	1	
		Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
		Spektori i Operacioneve Doganore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Zyra e Skanerit	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
		Zyra e Terminalave të Trageteve	Përgjegjës Zyre	C1	2	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	16	IV-a
		Zyra e Pikës Kontrollit	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2	
			Përgjegjës Zyre	C1	2	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
		Zyra e Përpunimit të Anijeve	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	10	
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra e Regjimeve	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	10	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra e Akcizës	Doganier Regjime/Preferenca/Përfashtime	C2	5	IV-a
Përgjegjës Zyre	C1		1	III-b		
Terminali i Konteinerëve	Doganier Akcize	C2	5	IV-a		
	Përgjegjës Zyre	C1	2	III-b		
	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	8	IV-a		
Spektori Doganor Porto-Romano	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2			
	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
	Përgjegjës Turni	C1	2	III-b		
	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	18	IV-a		



		Totali Degës Doganore			119	
	Dega Doganore Rinas	Administrata	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magaziner	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Turni	C1	3	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	26	IV-a
		Sektori Cargo/Regjime	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik/Regjime	C2	5	IV-a
		Totali Degës Doganore			42	
8	Dega Doganore Elbasan	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magaziner	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	3	
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra Doganore RBH	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përrjashtime	C2	3	IV-a
			Përgjegjës Turni	C1	3	III-b
			Doganier Akcize	C2	9	IV-a
				Totali Degës Doganore		
9	Dega Doganore Qafë Thanë	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magaziner	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
			Përgjegjës Turni	C1	3	III-b
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	6	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
		Zyra e Skanerit	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përrjashtime	C2	3	IV-a
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
		Zyra Doganore Tushemisht	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2			
		Totali Degës Doganore			37	
10	Dega Doganore Korçë	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magaziner	C3	1	
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	1	
		Zyra e Regjimeve	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra e Akcizës	Doganier Regjime/Preferenca/Përrjashtime	C2	3	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra Doganore Goricë	Doganier Akcize	C2	2	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	3	IV-a		
	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	3			
		Totali Degës Doganore			24	
11	Dega Doganore Kapshticë	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magaziner	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
			Përgjegjës Turni	C1	3	III-b
		Zyra e Skanerit	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	9	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përrjashtime	C2	2	IV-a
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a



		Totali Degës Doganore			32	
12	Dega Doganore Vlorë	Administrata	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	3	
		Zyra e Regjimeve	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	9	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra e Akcizës	Doganier Regjime/Preferenca/Përrashtime	C2	2	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyre Doganore Himarë	Doganier Akcize	C2	2	IV-a
Përgjegjës Zyre	C1		1	III-b		
Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2		2	IV-a		
Zyra Doganore e Terminalit Bregdetar për depozitimim e naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b		
	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a		
		Totali Degës Doganore			3	
		Totali Degës Doganore			35	
13	Dega Doganore Fier	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	3	
		Zyra e Regjimeve	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra e Akcizës	Doganier Regjime/Preferenca/Përrashtime	C2	3	IV-a
			Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Zyra Doganore Ballsh	Doganier Akcize	C2	7	IV-a
Përgjegjës Turni	C1		3	III-b		
Doganier Akcize	C2		9	IV-a		
		Totali Degës Doganore			39	
14	Dega Doganore Berat	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku /Aposterior/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1	
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	1	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
			Doganier Regjime/Preferenca/Përrashtime	C2	2	IV-a
Zyra e Akcizës	Doganier Akcize	C2	2	IV-a		
		Totali Degës Doganore			13	
15	Dega Doganore Kakavije (Gjirokaster)	Administrata	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
			Përgjegjës Turni	C1	3	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	9	
		Zyra e Skanerit	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	12	IV-a
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përrashtime	C2	4	IV-a		
Zyra Doganore Sopikë	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	-	IV-a		
	Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	-			
		Totali Degës Doganore			40	
16	Dega Doganore Sarandë	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku /Aposterior/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magazinier	C3	1	
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2	
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
			Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
Zyra Doganore Qaf-Botë	Përgjegjës Turni	C1	2	III-b		
	Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a		



		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përrjashtime	C2	4	IV-a	
		Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	6		
		Totali Degës Doganore		27		
17	Dega Doganore Tri Urat (Përmet)	Administrata	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku /Aposterior/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretar/Arkivist/Magaziner	C3	1	
			Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b	
		Doganier Peshore/Pikë Kontrolli	C3	2		
		Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a	
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Përrjashtime	C2	3	IV-a
			Totali i Degës Doganore		15	
		Totali i degëve doganore		652		
		Totali i Administratës Doganore		1052		

VENDIM**Nr. 10, datë 11.1.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 648, DATË 28.7.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
AVOKATIN E TATIMPAGUESIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 105/2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 648, datë 28.7.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë ndryshon, si më poshtë vijon:

“Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kompetencat, detyrat funksionale dhe mënyrën e bashkëpunimit të Avokatit të Tatimpaguesve me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta.”

2. Pika 1, “Struktura”, shfuqizohet.

3. Në pikën 2, të vendimit, bëhen këto ndryshime:

a) Në nënpikën 2.2, pas fjalëve “Avokati i Tatimpaguesit...” shtohen fjalët “...shqyrton dhe analizon ankesat e paraqitura,..”;

b) Në nënpikën 2.3 hiqen fjalët “Si anëtar i stafit ekzekutiv të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve...”;

c) Nënpika 2.4 ndryshon, me këtë përmbajtje:

“2.4 Avokati i Tatimpaguesit analizon ankesat e paraqitura dhe rezultatet e shqyrtimeve dhe raporton te ministri i Financave, duke bërë propozime për përmirësime të mëtejshme procedurale e ligjore si dhe në administrimin tatimor e zbatimin e legjislacionit tatimor.”

4. Në pikën 3, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pas nënpikës 3.1 shtohen nënpikat 3.1.1 deri në 3.1.9, me këtë përmbajtje:

“3.1.1 Avokati i Tatimpaguesit ndjek e vëzhgon përmbushjen e procesit të informimit e të shërbimit të tatimpaguesit prej administratës tatimore, në respektim të së drejtës që ka çdo tatimpagues për të marrë informacion dhe për t’u asistuar, pa shpërblim, nga administrata tatimore për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor. Ky proces përfshin, por nuk kufizohet në, informimin dhe publikimin e informacionit të qartë e të kuptueshëm në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në funksion të informimit dhe shërbimit. Monitorimi mund të kryhet edhe nëpërmjet sondazheve, vëzhgimeve, intervistave, pyetësorëve në mënyrë elektronike ose në çdo lloj forme tjetër, për t’u siguruar që kjo e drejtë e tatimpaguesit është përmbushur nga administrata tatimore.

3.1.2 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik të tatimpaguesit nga administrata tatimore, për çështje që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore. Ai ndjek përmbushjen e detyrimit të administratës tatimore për nxjerrjen e qëndrimeve procedurale e teknike të unifikuara në zbatimin e legjislacionit për raste të njëjta, me qëllim një paraqitje profesionale të administratës tatimore.

3.1.3 Avokati i Tatimpaguesit ndjek dhe sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit për konfidencialitetin e të dhënave tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore gjatë ushtrimit të funksioneve, te tatimpaguesi ose palët e treta.

3.1.4 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës për njoftim të tatimpaguesit, sipas procedurës, mënyrës dhe formave të



përcaktuara në legjislacionin tatimor. Tatimpaguesi duhet të njoftohet për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij, me përjashtim të rasteve kur administrata tatimore vlerëson se ekziston rreziku real që, pas marrjes së njoftimit, tatimpaguesi ta transferojë pronësinë para përfundimit të vlerësimit tatimor.

3.1.5 Avokati i Tatimpaguesit ndjek e sigurohet për zbatimin e së drejtës për kontrollin të arsyeshme dhe në përputhje me përcaktimet, procedurat dhe afatet për kryerjen e kontrollit tatimor, periodicitetin e kryerjes së kontrolleve, kohën, vendin dhe kohëzgjatjen, sipas dispozitave të ligjit.

3.1.6 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit, në rastin e një mosmarrëveshjeje për një vlerësim tatimor, të kryer nga administrata tatimore, për të kërkuar dhe marrë përgjigje me shkrim, të arësytuar, për arsyet, mënyrën e vlerësimit dhe të vendimit të marrë.

3.1.7. Avokati i Tatimpaguesit ndjek e sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit për njohjen dhe pajisjen me vërtetime ose dokumentin zyrtar, të lëshuar nga administrata, për çdo të dhënë reale mbi situatën financiare tatimore të tij. Ai monitoron, gjithashtu, respektimin e së drejtës për të kërkuar nga administrata tatimore, në rrugë elektronike apo me shkrim, kopje të njësuara me origjinalin, për çdo dokument që ndodhet në dosjen e hapur për të, apo kopje të printuara e të certifikuara të të dhënave elektronike, të lidhura me të.

3.1.8 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit për t'u dëgjuar, kur ai e shpreh ose e kërkon atë, apo kur legjislacioni në fuqi e detyron administratën që, përpara marrjes së një vendimi, të dëgjojë tatimpaguesin.

3.1.9 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës së ankimit prej tatimpaguesit, si kundrejt një akti administrativ për çështje tatimore, ashtu edhe kundrejt veprimeve ose mosveprimeve të punonjësve të administratës tatimore. Administrata tatimore, në çdo rast, duhet të sigurohet që nëpërmjet procedurave ose veprimeve të saj e drejta e tatimpaguesit për t'u ankuar dhe për të siguruar një shqyrtim të pavarur administrativ të mos cenohet.”

b) Pas nënpikës 3.3 shtohen nënpikat 3.3/1 dhe 3.3/2, me këtë përmbajtje:

“3.3/1 Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe të marrjes me shkrim, nga strukturat e administratës tatimore, të çdo informacioni të përgjithshëm apo të veçantë për një tatimpagues apo një grup tatimpaguesish, në çdo fazë të procesit administrativ. Ai mund të kërkojë informacion pranë çdo strukture të administratës tatimore, përfshirë Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për aq sa nuk cenohen interesat e hetimit tatimor, siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim. Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe të marrjes së informacionit edhe nga strukturat përkatëse të shqyrtimit administrativ tatimor në Ministrinë e Financave.

3.3/2 Avokati i Tatimpaguesve, në bazë të kërkesës së tatimpaguesit, ka të drejtë t'i rekomandojë drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nxjerrjen e vendimeve teknike, në përputhje me përcaktimet e nenit 10, të ligjit nr. 9920/2008. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në çdo rast, i kthen përgjigje të arësytuar Avokatit të Tatimpaguesve për marrjen parasysht ose jo të rekomandimit, brenda një afati 30-ditor.”

c) Nënpika 3.8 riformulohet, me këtë përmbajtje:

“3.8 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritet të rekomandojë përmirësimin e procedurave tatimore si dhe të rekomandojë lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës.”

ç) Pas nënpikës 3.8 shtohen nënpikat 3.8.1 dhe 3.8.2, si më poshtë vijon:

“3.8.1 Avokati i Tatimpaguesit nxjerr rekomandime me karakter të përgjithshëm, në lidhje me çështjet e identifikuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, dhe i përdor ato si bazë për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit përkatës.

3.8.2 Avokati i Tatimpaguesit nxjerr rekomandime me shkrim, drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore dhe/ose i paraqet këto rekomandime në seancat dëgjimore administrative, të mbajtura nga Drejtoria e Apelit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore.”

5. Në nënpikën 4.2, hiqen fjalët “Duke qenë se raporton direkt te drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve,..”.



6. Nën pikat 5.1 dhe 5.2 ndryshojnë, me këtë përmbajtje:

“5.1 Avokati i Tatimpaguesit i raporton me shkrim, periodikisht, një herë në tre muaj, ose sa herë që ai e kërkon, ministrit të Financave. Në të njëjtën kohë, ky raport i dërgohet edhe drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

5.2 Përveç raportimit periodik, në rastet kur e gjykon të arsyeshme, për situata apo çështje të veçanta, Avokati i Tatimpaguesit i raporton ministrit të Financave.”

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 19, datë 11.1.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
LEGALIZIMIT TË OBJEKTEVE ME LEJE
NDËRTIMI, NË TË CILAT JANË KRYER
SHTESA ANËSORE DHE/OSE NË
LARTËSI OSE NDRYSHIME TË
FUNKSIONIT TË HAPËSIRAVE DHE TË
OBJEKTEVE SHUMËKATËSHE PA LEJE,
TË DESTINUARA PËR KALIMIN E SË
DREJTËS SË PRONËSISË APO
QIRADHËNIEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 36 e 43/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. LEGALIZIMI NË FAVOR TË
POSEDUESVE TË OBJEKTEVE ME LEJE
NDËRTIMI, NË TË CILAT JANË KRYER
SHTESA ANËSORE DHE/OSE NË LARTËSI
OSE NDRYSHIME TË FUNKSIONIT TË
HAPËSIRAVE**

1. Procedurat e legalizimit të objektit me leje ndërtimi, në të cilin janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshim i funksionit të hapësirave, kryhen në favor të poseduesve (si porositës apo pronarë truall, sipas kontratave të porosisë/sipërmarrjes ose aktmarrëveshjes) në rastet e mëposhtme:

a) Subjekti ndërtues/investitori është në kushtet e nenit 99 (ose 187) të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ose

b) Subjekti ndërtues/investitori nuk dorëzon brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e njoftimit dokumentacionin e kërkuar zyrtarisht nga ALUIZNI sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, ose nuk shlyen, brenda të njëjtit afat, detyrimet financiare sipas nenit 43, të të njëjtit ligj. Këtu përfshihet dhe rasti kur subjekti rezulton me veprimtari të pezulluar prej të paktën 1 viti, sipas informacionit të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit; ose

c) Subjekti ndërtues/investitori nuk ka paraqitur aplikim për legalizim, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Kur plotësohen kushtet e pikës 1, të këtij vendimi, drejtoritë e ALUIZNI-t vijnë legalizimin në favor të poseduesve të apartamenteve ose ambienteve me funksion social-ekonomik, në vijim të quajtura “njësi individuale”, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim.

3. Drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t, pas kryerjes së procedurave të evidentimit në terren, hartojnë listat e ndërtimeve të ngritura nga subjektet që gjenden në kushtet e pikës 1, të këtij vendimi, si dhe listën e poseduesve të njërive individuale dhe i afishojnë ato në faqen zyrtare të ALUIZNI-t, në ambientet e drejtorive dhe të objekteve që do t'i nënshtrohen procesit të legalizimit, si dhe pranë njërive të qeverisjes vendore.

4. Legalizimi dhe regjistrimi për objektet që trajtohen sipas këtij kreu, në varësi të gjendjes ligjore, kryhen në dy faza:

a) Miratimi i lejes së legalizimit për objektin kryesor (sipas projektit të miratuar nga organi kompetent) së bashku me shtesat anësore dhe/ose në lartësi të realizuara dhe të deklaruara nga subjekti ndërtues dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP në emër të ALUIZNI-t.

b) Miratimi i lejes së legalizimit për shtesat anësore dhe/ose në lartësi të realizuara dhe të deklaruara nga vetë subjektet poseduese.

5. U nënshtrohen kriterëve kualifikuese të parashikuara në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e



kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, vetëm shtesat në tejkalim të lejes së ndërtimit. Nëse shtesa gjendet në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, legalizohet dhe regjistrohet vetëm objekti kryesor.

6. Poseduesit e njësive individuale duhet të dorëzojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e afishimit publik sipas pikës 3, të këtij vendimi, dokumentacionin që provon marrëdhënien juridiko-civile me subjektin ndërtues/investitor. Miratimi i lejeve të legalizimit për njësitë individuale në favor të poseduesve kryhet pas zbatimit të procedurës së përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij vendimi.

7. Nëse objekti me leje ndërtimi, në të cilin janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshim i funksionit të hapësirave, është ngritur në truall privat, pronarët e truallit përfitojnë pjesët përkatëse në objektin kryesor dhe në shtesat e realizuara nga subjekti ndërtues/investitor, në përputhje me shkronjën “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

8. Njësitë individuale, për të cilat nuk janë lidhur kontrata porosie/sipërmarrjeje ose aktmarrëveshjeje, legalizohen në emër të subjektit ndërtues/investitor, me përjashtim të atyre që i takojnë pronarit të truallit sipas paragrafit të dytë, të shkronjës “c”, të nenit 37, të ligjit të sipërpërmendur. Në rastet e shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, kur mbi njësinë individuale nuk ka pretendime nga të tretë, ajo legalizohet në favor të shtetit.

9. Në rastet e ekzekutimit të detyrueshëm mbi objektin apo mbi njësitë individuale zbatohen përcaktimet e pikave 8/3 deri në 8/7, të vendimit nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

Në çdo rast, ekzekutimi i detyrueshëm, që lidhet me pasuritë e subjektit ndërtues/investitor, nuk mund të shtrihet mbi njësitë individuale të poseduesve ose mbi shtesat e realizuara dhe të deklaruara prej tyre.

10. Kur për të njëjtën njësi individuale ka pretendime pronësie nga dy apo më shumë

persona, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata. Procedurat e legalizimit pezullohen vetëm për njësinë individuale që është objekt i mosmarrëveshjes, me paraqitjen e vërtetimit gjyqësor nga pala e interesuar apo me vendim gjyqësor për vendosjen e masës së sigurimit të padisë. Këto procedura rinisin në përputhje me dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, të dorëzuar nga subjekti i interesuar.

11. Procedurat e legalizimit sipas këtij kreu nuk pengohen nga detyrimet kontraktore që mund të ekzistojnë ndërmjet poseduesve dhe subjektit ndërtues/investitor lidhur me njësitë individuale dhe as nuk i shuajnë këto detyrime.

12. Regjistrimi i njësive individuale dhe i pjesës takuese të bashkëpronësisë kryhet sipas lejes së legalizimit. Për këtë qëllim, zbatohen procedurat e parashikuara në vendimin nr. 1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”. Poseduesit e njësive individuale, krahas pagesës së tarifës së regjistrimit për këto njësi, paguajnë solidarisht edhe tarifën e regjistrimit të objektit në tërësi sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij vendimi.

13. Akti për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit në tërësi, sipas nenit 37, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, depozitohet nga poseduesit e njësive individuale.

14. Për pagesën e tarifës së shërbimit nga poseduesit zbatohen pikat 2 deri në 4/1, të vendimit nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, të ndryshuar.

15. Penalitetet sipas nenit 43, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe detyrimet tatimore, të parashikuara nga nenet 11 dhe 20, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, mbarten nga subjekti ndërtues/investitor dhe nuk pengojnë legalizimin në favor të poseduesve, sipas këtij kreu.

Penalitetet llogariten nga drejtoria e ALUIZNI-t dhe i njoftohen Drejtorisë së Përgjithshme të



Tatimeve. Nëse subjekti është duke iu nënshtruar procedurave të falimentit, ato i njoftohen edhe personit të ngarkuar me likuidimin e shoqërisë tregtare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Detyrimet tatimore mbarten nga subjekti ndërtues, edhe pse kalimi i së drejtës së pronësisë mbi njësitë individuale kryhet nga ALUIZNI nëpërmjet lejes së legalizimit. Sipas kësaj pike, ALUIZNI përcjell pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e detyrimeve tatimore.

Pagesa për taksën e ndikimit në infrastrukturë nuk pengon legalizimin sipas këtij kreu dhe kryhet në çdo rast nga subjekti ndërtues/investitor.

16. Rastet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, për efekt të detyrimeve të subjektit ndërtues/investitor për pagesën e penaltetit dhe tatimit, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga institucionet tatimore dhe ato të mbikëqyrjes së shoqërive tregtare.

II. LEGALIZIMI NË EMËR TË SUBJEKTTI NDËRTUES/INVESTITOR

17. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, që nuk trajtohen sipas kreut I, të këtij vendimi, leja e legalizimit miratohet për subjektin ndërtues/investitor që rezulton i tillë nga leja e ndërtimit apo për subjektin që ka fituar të drejta mbi ndërtimin, nëpërmjet:

a) veprimeve juridiko-civile (kontrata, akte noteriale) për kalimin e të drejtave mbi objektin, nga investitori/ndërtuesi të një subjekt tjetër;

b) vendimit gjyqësor të formës së prerë.

18. Legalizimi nuk pengohet nga detyrimet tatimore që kanë palët si rezultat i veprimeve të kryera më parë për kalimin e të drejtave mbi objektin dhe as nuk i shuan këto detyrime. Sipas kësaj pike, ALUIZNI, në momentin e dërgimit të lejes së legalizimit për regjistrim, përcjell kopje të dokumentacionit të praktikës për vlerësimin e detyrimeve tatimore, pranë drejtorisë rajonale të tatimeve.

Kur kalimi i të drejtave mbi objektin është kryer pa kundërshtim, zbatohen përcaktimet e pikës 9, të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 9, datë 26.2.2008, të ndryshuar.

19. Rregullat e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 9, të këtij vendimi, zbatohen edhe për objektet që legalizohen sipas këtij kreu.

III. LEGALIZIMI I OBJEKTEVE SHUMËKATËSHE PA LEJE NDËRTIMI, TË DESTINUARA PËR KALIM PRONËSIE APO QIRADHËNIE

20. Evidentimi i objekteve shumëkatëshe (mbi 5 kate), të ngritura pa leje ndërtimi të organeve kompetente, për qëllim shitblerjeje apo qiradhënieje të njërive individuale të banimit apo shërbimit, kryhet nga drejtoritë e ALUIZNI-t, nëpërmjet bashkërendimit dhe shkëmbimit të informacionit me njësitë e qeverisjes vendore si dhe nëpërmjet procedurave të evidentimit në terren.

21. Subjekti, që ka ngritur ndërtimin shumëkatësh pa leje me qëllim shitblerjeje dhe/ose qiradhënieje, paguan:

a) taksën e ndikimit në infrastrukturë sipas ligjit për sistemin e taksave vendore. Procedura që ndiqet në zbatim të kësaj pike është ajo e përcaktuar në pikën 5, të vendimit nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, të ndryshuar.

b) tarifën për legalizim, në po të njëjtën masë.

Tarifa për legalizim paguhet nga subjekti që ka ngritur ndërtimin, pranë ALUIZNI-t, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit me shkrim, duke ndjekur të njëjtën procedurë si në pikën 4/1, të vendimit nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, të ndryshuar.

22. Nëse për legalizimin e objektit shumëkatësh kanë aplikuar si ndërtuesi ashtu dhe banorët, procedurat e legalizimit për objektin kryhen vetëm në emër të ndërtuesit. Përfundimisht, kur subjekti, që ka ngritur ndërtimin, u ka kaluar të drejtat mbi njësitë individuale përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi ose kur nuk plotëson dokumentacionin e nevojshëm për legalizim, procedurat vijojnë në favor të banorëve.

23. Kur leja e legalizimit miratohet për banorët e njërive individuale, ata paguajnë vetëm taksën e ndikimit në infrastrukturë, në përputhje me paragrafin e tretë, të pikës 3, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.



24. Veprimet juridiko-civile të ndërtuesit (aplikues për legalizim), të kryera pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për kalimin e të drejtave mbi objektin që legalizohet sipas këtij kreu apo mbi njësitë individuale, nuk merren parasysh nga drejtoritë e ALUIZNI-t. Përjashtim nga ky rregull bëjnë rastet kur procedurat e legalizimit kryhen për poseduesit e njërive individuale.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

25. Problematikat e pozicionimit të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit dhe/ose të sheshit të ndërtimit zgjidhen duke u mbështetur në gjendjen faktike ndërtimore, të evidentuar në terren. Drejtoritë e ALUIZNI-t vijojnë legalizimin e objektit sipas këtij evidencimi, pavarësisht nga ndryshimi midis gjendjes faktike dhe dokumentacionit të lejes së lëshuar nga autoriteti vendor.

26. Në rastin kur rezulton se objekti/sheshi i ndërtimit shtrihet jashtë truallit të përcaktuar në lejen e ndërtimit, drejtoritë e ALUIZNI-t procedojnë sipas neneve 15/1 dhe 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, nëse nuk arrihet marrëveshje juridiko-civile mes palëve private.

Këto dispozita zbatohen edhe kur ka ndryshime të gjendjes juridike të pronësisë të sheshit të ndërtimit, në raport me dokumentacionin e lejes përkatëse të ndërtimit.

27. Për efekt të llogaritjes dhe arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha ndërtimet që trajtohen sipas këtij vendimi, drejtoritë e ALUIZNI-t zbatojnë procedurat e parashikuara në pikën 5, të vendimit nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, të ndryshuar.

28. Në fund të pikës 11, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”, shtohen fjalët “... ose kur gjendja juridike e pronësisë së sheshit të ndërtimit ka ndryshuar.”.

29. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave,

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 41, datë 5.1.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 27.5.2014, “MBI KËRKESAT TEKNIKE DHE STANDARDET E OPERIMIT TË OFIÇINËS SË AUTORIZUAR TË TAHOGRAFIT”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 177, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 10211, datë 23.12.2009, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tahogرافit dixhital në Shqipëri””, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1054, datë 22.12.2010, “Për miratimin e rregullores mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 4, datë 27.6.2014 “Mbi kërkesat teknike dhe standardet e operimit të ofiçinës së autorizuar të tahogرافit”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në fund të pikës 2, neni 6, shtohet paragrafi “Autorizimi në rinovimin e parë jepet me afat 1 (një) vit. Në rinovimin e dytë e në vazhdim, Autorizimi jepet me afat 5 (pesë) vjet.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 6445/3, datë 9.1.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE
 ZYRTARE QË DO TË ZBATOHEN NGA
 AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE,
 PËR SHËRBIMET E OFRUARA PREJ SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të neneve 26, pika 6 dhe 28, pika 5, të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të pikës 9, kapitulli II, të vendimit nr. 222, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj”, si dhe të vendimit nr. 432, datë 28.6.2006 të Këshillit të ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, me propozim të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave,

URDHËROJNË:

1. Agjencia e Trajtimit të Pronave, gjatë procedurave për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, për të gjitha shërbimet e ofruara prej saj, zbaton tarifën financiare si më poshtë vijon:

Emërtimi i shërbimit të ofruar	Tarifat në lekë
a) për paraqitjen e kërkesës dhe hapjen e dosjes së re të njohjes dhe kompensimit	3000
b) kërkesë për kompensim	2000
c) kërkesë për kompensim në vlerë për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtime informale	2000
d) kërkesë për tjetërsimin e sipërfaqes oborr në përdorim	3000
e) kërkesë për lëshim kopjeje dokumentacioni të administruar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave:	
- deri në 100 fletë	20 lekë/fletë
- mbi 100 fletë	3000 lekë

2. Fondi i krijuar nga zbatimi i këtyre tarifave derdhet 100% në buxhetin e shtetit.

3. Urdhri nr. 8867/2, datë 28.12.2006, “Për miratimin e tarifave zyrtare që do të zbatohen nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për shërbimet e ofruara prej saj”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

KËRKESË
Nr. 5435/8, datë 5.1.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim-ndriçim i aksit rrugor blloku 11.2 ha në lagjen “Besëlidhja””, faza e tretë, Bashkia e Lezhës.

Subjekti kërkues është Bashkia e Lezhës.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 9 751 976 (nëntë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE
 TË BRENDSHME
Elona Gjebrea



Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të realizimit të projektit
 “Sistemim, asfaltim-ndriçim i aksit rrugor bloku 11.2 ha në lagjen Besëlidhja”, faza e tretë, Bashkia Lezhë.

Nr	Pronari Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	ZK	Truall			Ndërtesë			Njësi shërbimi			Vlera e përgj./lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
				Sip./ m ²	Çmimi/ lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip./m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip./m ²	Çmimi/lekë/ m ²	Vlera në lekë		
1	Mark Doda	4-53/N 4/53+1-1	8632	62	8511	527682	71,24	56000	3 989 440	62	84433,13	5234854	9 751 976	Konfirmim nga ZRPPP
Totali												9 751 976		

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë